



Pranuar / Dorezuar Prenjens / Dorezuar Received / Dorezuar	22	12	3	viti god year
Organ detyrues Organ i detyruar Org. detyrues	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No.	Shtesa Billeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM8/HCI	7647	/2023	115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1327/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1327/2023 të datës 25.10.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër DM 697/2023 të datës 29.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "Transferim për shkak të ristrukturimit", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1327/2023 e datës 25.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (tutje AKP), me datë 25.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokolli:6678/2023 nën shenjën A.nr.1327/2023, kundër Vendimit DM 697/2023 të datës 29.09.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se transferimi i tij është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenin 65 paragrafi 4 dhe nenit 66 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pasi që për një çështje të tillë i njëjti nuk ka dhënë pëlqimin e tij paraprak si dhe pozita të cilën ankuesi e ka mbajtur me akt emërim "Kryesues i Njësisë për Negocim Direkt" nuk është shuar

me rastin e riorganizimit të institucionit, me potencimin se ankuesi nuk kishte parashtruar ankesë asaj kohe kundër Vendimit të datës 22.02.2023 për transferimin e përhershëm të tij, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit duke e anuluar Vendimin e datës 29.09.2023 me shifër DM697/2023 ndërsa ta obligoi Agjencinë Kosovare të Privatizimit që ankuesin ta kthejë në pozitën Shef i Divizionit për Negocim Direkt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.11.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli më datë 10.11.2023 dhe 20.12.2020 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6678/2023 të datës 25.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 24.10.2023 dërguar nga ankuesi për Këshillin; Vendimin e datës 29.09.2023 me shifër DM697/2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Vendimin e datës 22.02.2023 me shifër DM62/2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Vendimin e datës 07.07.2023 me shifër DM251/2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.11.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 10.11.2023; Vendimin e datës 06.12.2022 me shifër DM1065/2022; Udhëzuesin e datës 06.12.2022 për transferimin e ankuesit; Akt emërimit e ankuesit të datës 10.01.2023; Përkrahimin e detyrave të punës të datës 12.02.2019; Përkrahimin e detyrave të punës të datës 11.07.2017; Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së i datës 30.11.2022; Vendimin e datës 14.12.2022 me shifër DM1118/2022; Vendimin e datës 14.02.2023 me shifër DM37/2023; Propozimin e datës 15.02.2023 me shifër: Nr.KR/21/2023; Vendimin për transferimin e ankuesit të datës 22.02.2023 me shifër DM62/2023; Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së i datës 29.05.2023; Vendimin e Drejtorit të Burimeve Njerëzore të AKP-së i datës 07.07.2023; Udhëzuesin e datës 07.07.2023 për transferimin e ankuesit; Vendimin e datës 04.09.2023 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKP e datës 04.09.2023; Strukturën Organizative të AKP-së; Propozimi e Komisionit të Ristrukturimit me shifër Nr.KR/32/2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 ka aprovuar Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datë efektive të hyrjes në fuqi nga 01.06.2023 dhe si rezultat i kësaj ka pasur shuarje të disa pozitave dhe ndryshime në përkrahimin e vendeve të punës të disa pozitave, ndërsa përmes Vendimit DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të çdo nëpunësi civil si pasojë e miratimit të Rregullores se re, kurse sipas Vendimit DM37/2023 të datës 14.02.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore është

ndryshuar Vendimi DM 1118/2022 i datës 14.12.2022 lidhur me ndryshimin e njërit nga anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi me datë 06.12.2023 përmes vendimit me shifër DM1065/2022 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore nga pozita Kryesues i Njësisë për Negocim Direkt është transferuar përkohësisht në pozitën kryesues i Njësisë për Përgatitjen e Kontratave të Shitjes-Njësia për Përgatitjen e Kontratave të Shitjes në Departamentin e Shitjes dhe ate me periudhë kohore efektive nga data 01.01.2023 deri me datë 30.06.2023.

Si pasojë e riorganizimit të institucionit, Komisioni i Ristrukturimit përmes rekomandimit të datës 15.02.2023 me shifër 21/2023 kishte rekomanduar që ankuesi të transferohet në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Kontratave të Shitjes në Departamentin Ligjor dhe Sekretarisë Ekzekutive, dhe për rrjedhojë Departamenti i Burimeve Njerëzore të AKP-së me datë 22.02.2023 përmes Vendimit me shifër DM62/2023 e kishte transferuar ankuesin në mënyrë të përhershme në pozitën *“Udhëheqës i Divizionit të Kontratave të Shitjes në Departamentin Ligjor dhe Sekretarisë Ekzekutive”* dhe atë me datë efektive nga 01.06.2023 (data e krijimit të efekteve juridike është lidhur me datën e hyrjes në fuqi të rregullores së re) dhe po ashtu vendimi në fjalë e ka përmbajtur këshillën e dhënë juridike se në rast të pakënaqësisë së ankuesit, i njëjti mund të parashtrojë ankesë na afat prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo ankuesi sikurse e potencon edhe ankesën e parashtruar në Këshill me datë 25.10.2023 se nuk e ka kundërshtuar vendimin e datës 22.02.2023 për transferimin e përhershëm të tij asaj kohe.

Përmes Vendimmarrjes së AKP-së afati për hyrje në fuqi të Rregullorja Nr. 07/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ishte shtyre për datë 01.09.2023, kurse Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datë 04.09.2023, ka nxjerr Vendim me të cilin ka aprovuar Rregulloren Nr. 05/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me arsyetimin se është konstatuar nga Bordi se Rregullorja paraprake e miratuar me datë 30.11.2022 ka nevojë për rishikime/përmirësime. Respektivisht sipas Rregullores Nr. 05/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, konkretisht sipas nenit 43 është shfuqizuar Rregullorja Nr. 07/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa sipas vendimit të lartcekur kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01.10.2023.

Drejtori i Burimeve Njerëzore i Agjencinë Kosovare të Privatizimit më datës 29.08.2023 kishte nxjerr Vendimin DM 653/2023 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit, ndërsa sipas Vendimit me numër DM 666/2023 të datës 07.09.2023 është amandamentuar Vendimin DM 653/2023 kështu që Komisionit të Ristrukturimit i vazhdohet afati i punës për tridhjetë (30) ditë nga data e nxjerrjes së këtij vendimi, kjo është bërë me arsyetimin se është miratuar Rregullorja Nr. 05/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Komisioni i Ristrukturimit me datë 27.09.2023 ka nxjerrë propozimin me shifër KR/32/2023 përmes të cilit bënë përcaktimin e transferimeve përkatëse me tabelën e bashkangjitur në mes tjerash edhe ankuesi me datë efektive nga 01.10.2023, kurse Departamenti i Burimeve Njerëzore me datë 29.09.2023 nxjerr Vendimin me shifër DM697/2023 përmes të cilit e bënë plotësimin

ndryshimin vendimit paraprak të datës 22.02.2023 lidhur me transferimin edhe të ankuesit, respektivisht i njëjti sipas tabelës së bashkangjitur mbetet i transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Kontratave të Shitjes në Departamentin Ligjor” kurse Departamenti i Burimeve Njerëzore të AKP-së në përgjigjen e dërguar për Këshillin me datë 10.11.2023 thekson faktin se ankuesit nuk i janë cenuar të drejtat respektivisht sipas vendimit të kontestuar të datës 29.09.2023 janë bërë vetëm korrigjime teknikes sa i përket ndryshimit të emërimit të departamentit sipas përcaktimeve të Rregullores Nr. 05/2023 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ku titulli “Departamentin Ligjor dhe Sekretarisë Ekzekutive” ndryshohet dhe bëhet vetëm “Departamenti Ligjor”, pa prekur pozitën e ankuesit.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me çështjen e transferimit të tij, Kolegji i Këshillit lidhur me ekzekutueshmërinë e aktit administrativ iu referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 144 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet se: “Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar”, nga rrjedh se ankuesit i ka humbur e drejta në kuptim të afateve kohore lidhur me pretendimet ankimore për çështje e transferimit të përhershëm sipas Vendimit të datës 22.02.2023 me shifër DM62/2023 të Departamenti i Burimeve Njerëzore të AKP-së përmes të cilit ankuesi ishte transferuar në pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Kontratave të Shitjes në Departamentin Ligjor dhe Sekretarisë Ekzekutive”, gjegjësisht vendimi në fjalë është bërë i ekzekutueshëm pasi që ankuesi sikurse e deklaroi me vullnet të plotë edhe në ankesën e parashtruar në Këshill se ndaj të njëjtit akt nuk ka parashtruar ankesë, nga lenë të kuptohet se asaj kohe e ka pranuar si të mirëqenë aktin në fjalë dhe për pasojë goditja e vendimit të datës 29.09.2023 me shifër DM697/2023 nuk mund të konsumoi pretendimet ankimore për goditjen e nga akti administrativ i cili është bërë i ekzekutueshëm.

Lidhur me kontestin në fjalë sa i përket Vendimit të datës 29.09.2023 me shifër DM697/2023 përmes të cilit akt është ndryshuar apo plotësuar vendimi paraprak i transferimit e që ndërlihet me korrigjimin e titullit apo emërimit të departamentit në kuadër të të cilit vepron divizioni të cilin ankuesi do ta udhëheqë, respektiv titulli nga “Departamentin Ligjor dhe Sekretarisë Ekzekutive” ndryshohet dhe bëhet vetëm “Departamenti Ligjor” ndërsa ankuesi do të ushtrojë pozitën e njëjtë funksionale “Udhëheqës i Divizionit të Kontratave të Shitjes”, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “24.3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative.” dhe nenit 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil” dhe erdhi në përfundimin se ankesa e ankuesit e datës 25.10.2023 e parashtruar në Këshill është e palejueshme pasi që ndryshimi i emërimit të departamentit në kudër të cilit funksionon pozita që do të mbaj ankuesi, nuk cenon asnjë të drejtë që buron nga marrëdhënia e tij e punës, pasi që ankuesi sërish do të ushtrojë pozitën e njëjtë “Udhëheqës i Divizionit të Kontratave të Shitjes”, kurse lidhur me vendimmarrjen për transferimin e ankuesit sikurse u konstatua edhe më lartë në arsyetimin e këtij

vendimi ankuesi nuk i ka përfillur afatet kohore dhe këshillën juridike, gjegjësisht aktin fillestar për transferimin e përhershëm e ka pranuar si të mirëqenë.

Prandaj, Kolegji për Shqyrtimi de Vendosjen e Ankesave, nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 25.10.2023 është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji;1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji."

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciumi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1327/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

